



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
AGJENCIA E INTELIGJENCËS FINANCIARE

SHPALLJE VENDI VAKANT PËR POZICIONIN:

1. TË DHËNAT PËR POZICIONIN E PUNËS VAKANT:

Emërtesa e pozicionit: Specialist në Sektorin e Mbikëqyrjes, në Drejtorinë e Përputhshmërisë, në Agjencinë e Inteligjencës Financiare, kategoria e pagës: IV-1

Numri i Pozicioneve vakant: 2 (dy)

2. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT:

Specialisti në Sektorin e Mbikëqyrjes, në Drejtorinë e Përputhshmërisë përgjigjet për zbatimin e planeve periodike të punës në funksion të mbikëqyrjes efektive nëpërmjet inspektimeve në distancë, mbi qasjen e bazuar në rrezikun PP/FT, rritjen e nivelit të përputhshmërisë dhe kapaciteteve parandaluese të subjekteve mbi detyrimet në fushën PPP/F dhe vlerëson riskun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit sipas kategorive të subjekteve.

3. DETYRAT KRYESORE:

- Mbledh, përpunon dhe analizon të dhënat e përputhshmërisë, vlerësimin kombëtar të riskut PP/FT, informacionin e strukturave të AIF-së, raportet e publikuar nga autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese, raporte apo publikime sektoriale apo të subjekteve të caktuara në funksion të hartimit të planeve afatshkurtra dhe afatmesme të përputhshmërisë;
- Harton vlerësime sektoriale të riskut PP/FT të subjekteve të ligjit dhe vlerësimin e integruar në baza dy-vjeçare;
- Propozon masë administrative ndaj subjekteve, të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative si dhe zbatimin e procedurave të vlerësimit të këtyre masave në përputhje me ligjin;
- Administrojnë dhe përditësojnë regjistrat elektronik (adresat, numrat e telefonit, adresat elektronike, personat e kontaktit, etj) të Autoriteteve Mbikëqyrëse si dhe të vetë subjekteve raportuese;

-
- Kontrollon në mënyrë periodike saktësinë dhe afatet e raportimit të RTPF nga subjektet e ligjit. Raporton në baza periodike te Përgjegjësi i Sektorit, në lidhje me problematikat e evidentuara dhe masat e ndërmarra;
 - Të vlerësojë nevojat dhe tematikat për trajnim sipas kategorive të subjekteve të ligjit dhe të informojë në baza periodike Drejtorin e Drejtorisë së Përputhshmërisë;
 - Siguron ndjekjen dhe realizimin e detyrave të sektorit, me qëllim që të arrihen objektivat e parashikuar, duke përdorur me efektivitet burimet në dispozicion;
 - Ndjek realizimin e detyrave të përcaktuara në planin vjetor të punës apo nga eprorët;
 - Gjatë procesit të vlerësimit të përputhshmërisë dhe më tej ofron asistencë për subjektet e ligjit;

4. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI

Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati janë:

- të jetë shtetas shqiptar;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- të mos ketë filluar ndjekja penale ndaj tij;
- të mos jetë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- të mos jetë larguar për shkelje disiplinore nga administrata publike, si dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi të rëndë sipas Kodit të Punës, apo të rëndë dhe shumë të rëndë sipas legjislacionit për shërbimin civil apo legjislacion tjetër të ngjashëm;
- të mos i jetë hequr e drejta e ushtrimit të detyrës në administratën publike me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- të mos ketë konflikt interesi me detyrën ose funksionin që do të kryejë;
- të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posaçme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës.

5. KËRKESAT E POSAÇME:

Arsimi minimal: Diplome “Master shkencor” në shkenca Juridike/Ekonomike Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

Përvoja: Të ketë 2 vite përvojë pune në profesion

Tjetër: Njohuri të mira të gjuhës angleze

Kandidati i shpallur fitues do ti nënshtrohet procedurave për tu pajisur me “Certifikatë Sigurie” sipas kuadrit ligjor në fuqi.

6. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a. Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe në përputhje me standardet e legjislacionit shqiptar (<https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>);
- b. Fotokopje të diplomës. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f. Dëshmi të gjendjes gjyqësore;
- g. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- h. Vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

Kandidatët e interesuar paraqesin kërkesën për aplikim dhe dokumentacionin e cituar më sipër brenda datës **28.08.2024 (afati i fundit i aplikimit)** në zyrën e protokollit të institucionit me adresë: **Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr.3, Tiranë.**

7. DATAT E TESTIMIT DHE MËNYRA E NJOFTIMIT

- Për datën dhe vendin e testimit me shkrim dhe intervistës me gojë, kandidatët e kualifikuar do të njoftohen nëpërmjet email-it duke filluar nga data 30.08.2024
- Të gjithë kandidatët e skualifikuar do të njoftohen me email, për arsyet e skualifikimit.

8. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuri mbi Ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar;
- Njohuri mbi Ligjin nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar;
- Njohuri mbi Ligjin nr. 72/2019 “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- Njohuri mbi VKM nr. 343, datë 08.04.2009, “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të autoriteteve licencuese dhe/ose mbikëqyrëse”;

-
- Njohuri mbi VKM Nr. 13, datë 11.1.2024 “Për përcaktimin e procedurave të konstatimit, të shqyrtimit, të propozimit dhe të vendosjes së masave administrative nga Agjencia e Inteligjencës Financiare”
 - Njohuri mbi VKM Nr. 51 31.01.2024 “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Inteligjencës Financiare”;
 - Njohuri mbi VKM Nr. 458, datë 10.6.2020 “Për përcaktimin e faktorëve dhe të situatave që merren parasysh në vlerësimin e rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”;
 - Njohuri mbi VKM Nr. 538 dt.29.07.2022 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të detajuara për ngrirjen e përkohshme të fondeve apo të pasurive të tjera të personave ose enteve të shpallura nga strukturat përkatëse të këshillit të sigurimit të kombeve të bashkuara apo organizatat ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë”;

9. REZULTATET PËR FAZËN E KONKURRIMIT

Në vijim, AIF do të realizojë:

- Fazën e parë të konkurrimit e cila konsiston në verifikimin nga komisioni të dokumentacionit të dorëzuar;
 - a- nëse dokumentacioni i paraqitur nga çdo kandidat vërteton plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta në shpalljen për konkurrim.*
 - b- nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës;*
- Faza e dytë e konkurrimit është faza e testimit me shkrim dhe intervistimit të punonjësve të kualifikuar nga komisioni. Nëpërmjet kësaj faze kandidatët ndër të tjera synojnë të evidentojë formimin e tyre të përgjithshëm si dhe vizionin e tyre personal mbi veprimtarinë e AIF-së.

10. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Në përfundim të fazës së dytë Komisioni i Vlerësimit bën vlerësimin për secilin prej kandidatëve që janë kualifikuar në fazën e parë dhe kanë marrë pjesë në testimin me shkrim dhe intervistimin. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë. Kandidati që të shpallet fitues duhet të ketë marrë minimumi 70 pikë.